

VENDIM
Nr. 41, datë 29.4.2013

**MBI TRANSFERIMIN E AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË
“HEC ULËZ-SHKOPET” SHA, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS TE “KURUM INTERNATIONAL” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr. 94/2013, datë 4.3.2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100% të aksioneve të shoqërisë HEC Ulëz-Shkopet, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë Kurum International”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 9.1.2013 “Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe të kandidatit fitues për privatizimin e shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a.”, pikës 6.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 41, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe aplikimit të shoqërisë HEC Ulëz-Shkopet, për transferimin e kontrollit të shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” nga METE te “Kurum International” sh.a. dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC Ulëz-Shkopet” sh.a. nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te “Kurum International” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani